



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 818 Prot.

Lezhë, më 20 . 01 . 2021

VENDIM

Nr. 01 , Datë 20 / 01 / 2021

**Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2021 dhe përdorim të fondeve të trashëguara nga viti 2020**

Në zbatim të nenit 54 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e shtesës në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 në shumën 682,194,396 lekë, fonde të trashëguara nga viti 2020, konkretisht me burim nga:

- Transferta e pakushtëzuar në shumën 28,866,191 lekë;
- Transferta Sektoriale në shumën 7,997,310 lekë.;
- Të ardhurat në shumën 50,135,207 lekë;
- Transferta e kushtëzuar në shumën 595,195,688 lekë.

2.Miratimin e përdorimit të fondeve në shumën 682,194,396 lekë, sipas programeve buxhetore dhe strukturës ekonomike bashkëlidhur pasqyra nr.3, 3/1, 3/2, 3/3, 3/4.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

